



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8117

Tirane, date 15/12/2015

Drejtuar: Z.AGOSTIN JAKAJ
SHOQERIA "AJ - FD" SH.P.K
RRUGA E KAVAJES, PALLATI I DELIJORGJIT, LANA PARK, KULLA 2,
TIRANE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"
TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE
TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1184 date 15.04.2008.

I nderuar z. Jakaj,

Shoqëria "AJ - FD" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1184 date 15.04.2008, për gurë gëlqeror, mali i Pashkasheshit, ne Qarkun Tirane.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.8127 date 07.09.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.6025 date 08.09.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.1184 date 15.04.2008, për gurë gëlqeror, mali i Pashkasheshit, ne Qarkun Tirane, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2015 - 2016. Theksojmë se jeni njoftuar për fillimin e procedurave te revokimit edhe me shkresën tone 6061/1 date 13.11.2014, për të njëjtin problem, mos pagesën e garancive financiare te rehabilitimit te mjedisit, por gjate periudhës 30 ditore nga ana e shoqërisë tuaj u reflektua, u kryen pagesat dhe procedurat nuk vazhduan me tej.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germen “ç” të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa me sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1184 datë 15.04.2008, për gurë gëlqeror, mali i Pashkasheshit, në Qarkun Tiranë**, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1184 datë 15.04.2008, për gurë gëlqeror, mali i Pashkasheshit, në Qarkun Tiranë.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë” duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minierar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

